



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.544/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P., gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurës A.A., sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr.414/16 të dt.17.6.2016 për shkak të veprës penale : vetëgjyqësia nga neni 418par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurës A. A, mbrojtësit të të pandehurës av. O. C. nga Peja i caktuar sipas autorizimit dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha dhe në mungesë të të dëmtuarit A. V dhe të autorizuarit të tij av. G. K., dhe të me dt.07.12.2016 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurës

A. A. e lindur me dt. në P , rruga L, e bija Xh dhe nënës R e gjinisë N , boshnjake , shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

Konform nenit 363 par 1 nën par 1.1. të KPPK-së

REFUZOHET AKTAKUZA

Gjëja se :

Me dt. 12.1.2016 , e tutje , në Pejë në shtëpinë e saj në rrugën Lekë Dukagjini nr. 148 - ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon , në vend se ti drejtohet organit kompetent , ashtu që e përvetëson pasurinë e cila është besuar nga ana e të dëmtuarit A V nga Peja , në atë mënyrë që i dëmtuari para datës së lartcekur ia jep disa herë të pandehurës në përdorim personalë të përkohshëm veturën e tij Golf me targa 03-710-DI ndërsa kur i dëmtuari me datën e lartcekur kërkon nga e pandehura që të ia kthej automjetin e tij , e pandehura refuzon te ia kthej , me arsyetimin se i dëmtuari ia ka borxh disa rroga të papaguara dhe para të huazuara e të cilat arrijnë kundërvlerën e veturës . ku edhe me tutje e pandehura vazhdon ta mbaj në mënyrë të kundërligjshme automjetin e të dëmtuarit për borxhin që ia ka i dëmtuari.

-me çka kishte për të kryer vepre penale : vetëgjyqësia nga neni 418par 1 të KPRK-së

-sepse prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare hoqi dorë nga ndjekja penale kundër të pandehurës .

Automjeti i tipit “Golf” me targa të regjistrimit ----- pas plotfuqishmërisë të aktgjyqimit **ti kthehet të pandehurës përkatësisht pronares A.A.**

Shpenzimet procedurale ju ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 17.6.2016 kundër të pandehurës A. A ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.414/16, për vepër penale : të vetëgjyqësisë nga neni 418 par 1, të KPRK-së , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurën ta shpallë fajtores , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin gjyqësorë e pandehura pasi që paraprakisht është njoftuar me të drejtat dhe obligimet procedurale , me aktakuzën dhe mundësinë e deklarimit përkitazi me fajësinë – nuk e ka pranuar fajësinë për çka gjyqtari e ka bërë nxjerrjen e provave me ç rast është dëgjuar i dëmtuari A. V si dhe janë lexuar dhe shikuar: fatura e piramidës III . e dt. 27.7.2015 , dëftesa e Ambientit në emër të A. V fletëpagesa e IFJB V.CP të dt. 29.7.2016, fatura e tatimit në pronë e dt. 29.7.2015 , kontrata për shitblerjen e automjetit te dt. 11.4.2014, si dhe në fund është dëgjuar edhe mbrojtja e të pandehurës A. A.

Çfarë u tha në shqyrtim :

I dëmtuari ka deklaruar se:

“Këtu e pandehura ka qenë një kohë punëtore në firmën time “Terrasistem” në vitin 2011-2012 ekzistojnë edhe të dhënat e sakta për këtë punë . të gjitha pagat këtu e pandehura i ka marrë përmes bankës , ndoshta ndonjë e ka marrë edhe jashtë bankës por pjesën dërmuese në bankë. Automjeti lëndor është i imi : e pandehura ma ka kërkuar veturën për ta marrë një kredi, unë pranova që t’ia bëjë të mirën këtu të pandehurës dhe veturën time për të cilën sot po flasim ia kam qit në emër të saj te noteri Stavileci në Pejë. Unë veprova kësisoj sepse e pandehura këtë e kërkoj nga unë. Unë e kamë bërë këtë punë – kontratë vetëm për t’ia mundësuar të pandehurës që të marr kredi edhe pasi që është bërë kontrata automjeti gjithë kohën ka qëndruar tek unë. Unë ju betohem se kjo kontratë mbi shitblerjen e automjetit është lidhur vetëm formalisht për shkak se qëllimi i kësaj kontrate ka qenë marrja e kredisë. Nuk e di nuk jam i sigurt. Kur është vërtetuar tek Noteri B. S. edhe unë kamë qenë prezentë bile kam qenë vet i 5-ti . e kamë nënshkruar këtë kontratë me vullnetin tim të plotë. Shumicën e kohë automjeti në fjalë ka qenë tek unë , ndërkohë që unë këtë automjet ia kam dhënë të pandehurës sa herë që ka kërkuar. Në atë firmë unë kamë qenë shef dhe kemi punuar bashkë me disa Austriak dhe kemi pas të punësuar 12-13 punëtorë. Nuk e di saktë sinqerisht po ju them sa ka punuar e pandehura tek unë. Unë i kam ndihmuar të pandehurës deri në vitin 2015 . jam i sigurt se të pandehurës ia kam paguar të gjitha pagat – bile edhe më shumë . Kur është bërë kontrata për shitblerjen e automjetit tek noteri ka qenë prezentë e pandehura, unë, dhe 4 punëtor të mi si dhe ka qenë prezentë noteri B. S. Aty jemi nënshkruar : unë , e pandehura dhe Noteri. Nuk e kamë kërkuar prishjen e kontratës asnjëherë për shkaqe e cila e pandehura e din shumë mirë, ne kemi bërë kërkesë për kthimin e veturës dhe ndërkohë bashkë me avokatin tim G. K. e kemi bërë padinë civile për prishje të kontratës .Me të pandehurën kemi pas raporte të afërta deri në momentin kur ajo nuk ka pranuar që të ma kthej veturën, përndryshe unë i kamë ndihmuar krejt familjes së të pandehurës sa herë që ka pas nevojë”.

E pandehura në mbrojtjen e saj në mes tjerash ka deklaruar se:

“Automjetin në fjalë e kam fituar duke u bazuar në kontratën e datës 19.4.2014 që do të thotë se e kamë blerë nga shitësi A. V . Automjeti është regjistruar në emër tim. Automjetin në fjalë unë e kamë shfrytëzuar gjithë kohën . Veturën në fjalë herë pas herë ia kamë dhënë vëllait tim A në përdorim . Veturën në fjalë dy herë ia kam dhënë në shfrytëzim edhe shitësit përkatësisht këtu të dëmtuarit A. V. A. pasi që ka kryer punë me veturë të njëjtën rregullisht ma ka kthyer. Ditën kur policia ma kanë sekuestruar automjetin , i njëjti ka qenë në posedim në emër timin . Nuk ka ndodhur asnjëherë që shitësi i veturës këtu i dëmtuari A. V para këtij gjykimi të ketë kërkuar që unë t’ia kthej veturën në fjalë. Nuk është e vërtet se i dëmtuari përkatësisht shitësi A. V. këtë veturë e ka bartë në emër timin për shkak të një kredie e cila kinse më është nevojitur mua-kurrfarë kredie mua nuk më është dashur .Në jetën time vetëm një herë kamë marrë kredi edhe atë në vitin 2009 dhe atë për vlerë rreth 4.000 euro dhe kjo kredi nuk ka

lidhje me këtë rast dhe kjo kredi është paguar menjëherë pas dy muajsh. Është e vërtet se i dëmtuari më ka pas borxh pagesën e disa të ardhurave personale, dhe ne pikërisht jemi barazuar me borxhin që ma ka pas i dëmtuari pasi që e kemi nënshkruar kontratën për shitblerjen e automjetit –dhe kjo është bërë sipas marrëveshjes tonë të dy anshme dhe vlera e borxhit që ma ka pasur i dëmtuari është e barabartë me vlerën e veturës që ai ma ka shitur. Unë mendoj se i dëmtuari kohëve të fundit ka probleme psikike përndryshe nuk e di se si mund ta kërkoj veturën kur gjithçka është bërë sipas marrëveshjes së dy anshme”.

Në fjalën përfundimtare palët kanë deklaruar :

Prokurori i shtetit :

“Në këtë çështje penale gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë pas analizimit të shkresave të lëndës e sidomos kontratës së shitblerjes së automjetit e cila është përpiluar me dt.11.4.2014 para noterit B. S. ku objekt i kontratës ka qenë automjeti për të cilën dyshohet se e pandehura ka kryer vepre penale të vetëgjyqësi, kjo kontratë është bërë me vullnet të plotë në mes të pandehurës dhe të dëmtuarit e gjithashtu nga mbrojtja e të pandehurës e cila deklaroj se sot se këtë automjet e kishte bërë nga i dëmtuari dhe që nga ajo kohë asnjëherë nuk kishte pasur ndonjë problem për dy vite radhazi sepse çdo gjë ishte bërë me marrëveshje dhe me vullnetin e tyre , dhe pasi që i dëmtuari asnjëherë nuk e kishte kontestuar këtë kontratë të shitblerjes unë si prokurorie e çështjes duke u gjendur në një situatë të tillë vlerësoj se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vepër penale të vetëgjyqësisë sepse e pandehura ka një kontratë për shitblerje e cila përderisa ekziston prodhon efekt juridik andaj heqë dorë nga aktakuza PP /II 414/16 të dt. 17.6.2016” .

Meqenëse se prokurori shtetit hoqi dorë nga aktakuza përkatësisht nga ndjekja penale kundër të pandehurës, është vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit, përkatësisht ndaj të pandehurës është refuzuar aktakuza.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 363 par 1 pika 1.1. të KPPRK u vendos si në dispozitivin e aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 454 par 1 të KPPRK-së

Vendimi mbi kthimin e automjetit të sekuestruar është marrë konform nenit 116 par 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.07.12.2016

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi palës me të
Drejtë ankese i lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .